

Kriteret për pranim të stafit akademik të ftuar ne Masterin Profesional ne Restaurim Monumentesh Kulture:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet e plota universitare brenda ose jashtë vendit. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të njohura nga MAS.
2. Të ketë përfunduar studimet Master Shkencor (ekuivalente me te) në *profilin* Arkitekture / Restaurim ose një profil të përputhshëm me lëndën në të cilën do të japë mësim, ku nota mesatare do të jetë mbi 7.5. Preferohet mesatarja e lëndëve të specialitetit mbi 9.
3. Preferohen kandidatet të zotërojnë gradën DOKTOR ose te jete ne proces te mbrojtjes se Doktoraturës ne fushën e Restaurimit.
4. Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj perëndimore e mbrojtur dhe e vërtetuar me dëshmi. (preferohen gjuhët anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht).
5. Preferohen kandidatet që kanë kryer kurse kualifikime etj, apo që kanë bërë publikime brenda ose jashtë vendit, në fushën e specialitetit përkatës .

Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë kandidatët për stafin akademik të ftuar:

1. Kërkesë te veçantë me shkrim për secilën lëndë ku kërkon të konkurrojë (jo më shumë se pesë lëndë – kërkesat pa lëndë të specifikuara, nuk shqyrtohen nga komisioni).
2. Dokument identifikimi (kopje e notuar).
3. V të përgjithshme të përqendruar.
4. Diploma dhe të lista e notave (kopje e notuar).
5. Dëshmi te gjuhëve të huaja që zotëron.
6. Provime pasuniversitare, mikroteza etj.
7. Botime (monografi, artikuj, tekste mësimore, projekte).
8. Kualifikime brenda ose jashtë vendit.
9. Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore.
10. Raport mjeko-ligjor.
11. Dy letra referencash.

Shënim: Dorëzimi i dokumentacionit nga kandidatet, do të kryhet pranë Departamentit te Restaurimit dhe Teknologjisë se Arkitekturës deri në datën 28.10.2016.

Vlerësimi i kandidatëve për stafin akademik të ftuar:

Komisioni i vlerësimit, përbëhet nga jo me pak se tre anëtarë ku bëjnë pjesë përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i lëndës dhe minimalisht një anëtar tjetër nga personeli akademik efektiv.

- Vlerësimi i përmbajtjes të dosjes së dorëzuar nga konkurrenti (60 %)
- Vlerësimi i konkurrentit nëpërmjet një interviste në komisionin e vlerësimit (40%)

Ne përfundim te procesit, komisioni liston kandidatët në rend zbritës, dhe kjo listë shërben për plotësimin e vendeve vakante për mësimdhënie në lëndën përkatëse.



Lëndët ku konkurohet për stafin akademik të ftuar:

1	Mjedisi arkeologjik dhe ndërhyrjet restauruese
2	Historia dhe metoda te analizës se arkitekturës
3	Metodologjitë e rilevimit dhe prezantimi i monumenteve te kulturës
4	Katalogimi dhe muzeografia
5	Restaurimi: Ruajtja dhe Vlerësimi
6	Restaurimi i sipërfaqeve dekorative te arkitekturës
7	Konsolidimi i ndërtesave historike
8	Bazat ekonomike dhe menaxhimi i pasurisë kulturore